

Emri i Lëndës : E Drejtë Kushtetuese I

Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
LAW 115	A	Vjeshtë	3.00	1.00	0.00	3.50	5.00
Lektori Katrin Treska, PhD							
Asistenti							
Gjuha e kursit Shqip							
Niveli i lëndës Program i Integruar							
Përshtimi		Lënda do te fokusohet ne shpjegimin e parimeve kryesore dhe institucioneve te se drejtës publike, te tilla si shteti dhe e drejta, parimet e sovranitetit shtetëror, ndarjen e pushteteve, karakteristikat kryesore te shteteve dhe sistemet shtetërore. Në pjesën e parë, studentët njihen me rolin e teorisë së të drejtës në shkencat juridike në përgjithësi dhe në studimet juridike. Shpjegojhen teoritë më të rëndësishme për origjinën e shtetit dhe të së drejtës dhe për shkencat juridike në përgjithësi. Më pas analizohet struktura e shtetit, organet dhe funksionet e tij. Në vijim diskutohen elementet e shtetit dhe trajtat e tij. Në pjesën e dytë paraqitet koncepti i normave juridike, ndarja e normave juridike bazuar në kriteret e ndryshme si dhe struktura e normave juridike. Analizohet koncepti i marrëdhënieve juridike dhe diskutohen elementet bazë të marrëdhënies juridike (subjektët e së drejtës, objekti i së drejtës, e drejta subjektive dhe detyrimi juridik). Shpjegojhet koncepti i aktit juridik dhe diskutohen burimet e së drejtës (kushtetuta, ligji, aktet shtetërore nënligjore, aktet e personave publik dhe privat, e drejta zakonore, si dhe shkenca juridike). Pjesa e tretë paraqet studimin e konceptit të sistemit juridik dhe diskutohen njësítë themelore të sistemit juridik (norma juridike, institutet e së drejtës, degët e së drejtës, grupet e së drejtës). Më tutje, shqyrtohen teknikat themelore të interpretimit, mënyrat e zgjdhjes së cështjeve rreth zbrazëtirave juridike. Së fundi, shqyrtohen teori të ndryshme në lidhje me esencën dhe strukturën e së drejtës (teorisë së të drejtës natyrore, shkollën historike, teori e pastër e ligjit, etj).					
Objektivat							
Konceptet Kryesore		1. E drejta 2. Kushtetuta 3. Norma Juridike 4. Parime 5. Institucionet Publike 6. Pushtetet 7. Institucionet e pavarura					

Programi i Lëndës

Java	Tema
1	Koncepti i së drejtës publike. Shoqëria, shteti dhe e drejta. Ky leksion i dedikohet zërthimit teorik të lëndës. Studentët njihen me rolin e teorisë së të drejtës në shkencat juridike në përgjithësi dhe në studimet juridike. (Kapitulli 1)
2	Shteti; Koncepte te ndryshme per shtetin; Pushteti shteteror dhe sovraniteti. Shpjegojhen teoritë më të rëndësishme për origjinën e shtetit dhe të së drejtës dhe për shkencat juridike në përgjithësi. Më pas analizohet struktura e shtetit, organet dhe funksionet e tij. (Kapitulli 2)
3	Pushteti shteteror dhe sovraniteti. Shpjegojhen teoritë më të rëndësishme të pushtetit shteteror dhe sovranitetit. Mënyrat e ushtrimit te pushtetit. Kujt i perket sovraniteti. Po ashtu ushtrimi i sovranitetit permes perfaquesuesve. (Kapitulli 3)
4	Forma e shtetit; Parimi i unititetit te pushtetit. Në vijim diskutohen elementet e shtetit dhe trajtat e tij. Njekohesht ne leksion perfshihen forma te ndryshme te shtetit duke i pasqyruar me shembuj konkret. Uniteti i pushtetit trajtohet specifisht ne nje nje ore leksioni te vecante. (Kapitulli 4)
5	Parimi i ndarjes se pushteteve. Analizimi i pushteteve me rradhe; Pushteti Legjislativ, Pushteti Ekzekutiv dhe Pushteti Gjyqesor. Ndarja dhe Balancimi i pushteteve dhe kontrolli i ndersjellte i tyre. (Kapitulli 5)

6	Organizmi politik i shoqërisë dhe struktura e shtetit. Analizohet koncepti i marrëdhënieve juridike dhe diskutohen elementet bazë të marrëdhënies juridike: subjektët e së drejtës, objekti i së drejtës, e drejta subjektive dhe detyrimi juridik. Njekohesish, leksioni pason leksionin e meparshem duke u fokusuar ne strukturat kryesore te shtetit. (Kapitulli 6)
7	E Drejta, kuptimi i se drejtes; norma juridike. Shpjegohet koncepti i aktit juridik dhe diskutohen burimet e së drejtës (kushtetuta, ligji, aktet shtetërore nënligjore, aktet e personave publik dhe privat, e drejta zakonore, si dhe shkenca juridike (Kapitulli 7)
8	Provimi Norma juridike; Koncepte te ndryshme per te drejten. Nocioni i rendit juridik; Nocioni i normës juridike; Llojet e normave juridike; Vlefshmëria e normës juridike në territor (hapësirë); Vlefshmëria kohore e normave juridike; Fufia prapavepruese (retroaktive) e normave juridike; Struktura e normës juridike (Kapitulli 8) gjysmë final
9	Shteti dhe e drejta ne evolucionin e tyre historik. -shqyrtohen teori të ndryshme në lidhje me esencën dhe strukturën e së drejtës (teorisë së të drejtës natyrore, shkollën historike, teori e pastër e ligjit, etj (Kapitulli 9)
10	Koncepti i burimit te se drejtës. Trajtohen burimet e se drejtes, origina e tyre, burimet akte dhe burimet fakte (Kapitulli 10)
11	Burimet kryesore te se drejtës. Trajtim i specifikuar ne secilin prej burimeve kryesore te se drejtes, qe nga ligji themelor i vendit, marreveshjet nderkombetare te ratifikuara (e drejta nderkombetare), ligjet dhe zakoni (Kapitulli 11)
12	Marrëdhëniot juridike; Faktet juridike Elementet e marrëdhënies juridike; Subjektet e së drejtës (Personat fizikë dhe Personat juridik); Autorizimi juridik (E drejta subjektive, Keqpërdorimi i autorizimit, Keqpërdorimi i së drejtës subjektive, Kompetenca dhe Keqpërdorimi i kompetencës); Obligimi juridik (detyrimi) Gjendja juridike (statusi); Objekti i së drejtës Faktet juridike Parashkrimi (Kapitulli 12)
13	Zbatimi i se drejtës; Llojet dhe menyrat e interpretimit te ligjit Katër teoritë më të rëndësishme të së drejtës; E drejta natyrore; Pozitivizmi ligjor; Realizmi ligjor; Studimet kritike të së drejtës (Kapitulli 13)
14	Sistemi i se drejtës; Parimet e ndertimit te sistemit te se drejtes. -paraqet studimin e konceptit të sistemit juridik dhe diskutohen njësítë themelore të sistemit juridik (norma juridike, institutet e së drejtës, degët e së drejtës, grupet e së drejtës) - shqyrtohen teknikat themelore të interpretimit, mënyrat e zgjidhjes së cështjeve rrith zbrazëtirave juridike; (Kapitulli 14)
15	perseritje
16	Provim Final
Parakushtet Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.	
Literatura • Luan Omari, Parime dhe Institucionale te se Drejtës Publike (2013)	
Referanca të tjera • Luan, Omari. "Shteti i së drejtës." (2002). • MacCormick, Neil. Institutions of law: an essay in legal theory. OUP Oxford, 2007 • Kelsen, Hans. General theory of law and state. Vol. 1. The Lawbook Exchange, Ltd., 1945	
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Studentet do te jene ne gjendje te njohin burimet e shtetit dhe te se drejtës.
2	Studentet do te njohin parimet kryesore te funksionimit te shtetit dhe institucioneve te tij.
3	Studentet do te njohin format kryesore te organizmit shtetëror.
4	Studentet do te njohin format kryesore te organizmit shtetëror.
5	Studentët do te mund të kenë njohuri të gjera rrith anës historike, politike, sociologjike dhe filosofike të së Drejtës Publike në Shqipëri.
6	Studentet do te jene ne gjendje te njohin burimet e shtetit dhe te se drejtës.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës

Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja
Gjysmë finale	1	10
Kuize	0	0
Projekte	1	10
Projekte semestrale	0	0
Punë laboratori	0	0
Pjesëmarrja në mësim	1	10
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final	30	
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final	70	
Total	100	

Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)

Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	4	56
Detyra	1	2	2
Gjysmë finale	1	1	1
Provimi final	1	2	2
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			125
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.00
ECTS			5.00